Financuar nga
Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

# BULETIN INFORMATIV
## NEWSLETTER

Prill/ April
2024




Zbatuar nga/
Implemented by:

NALAS Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe

NALAS is institutionally supported by SDC.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Në partneritet me/
In partnership with:

SHOQATA PËR AUTONOMINE VENDORE

Co-PLAN

Eco Partners for Sustainable Development

Financuar nga
Bashkimi Evropian

# EU4MUNICIPALITIES




Zbatuar nga/
Implemented by:

Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe

NALAS is institutionally supported by SDC.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Në partneritet me/
In partnership with:

SHOQATA PËR AUTONOMINE VENDORE

Co-PLAN

Eco Partners for Sustainable Development

Financuar nga
Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES



# KUSH JEMI NE?
# WHO ARE WE?

Skema e Granteve "BE për Bashkitë" është një projekt pionier i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ku BE ofron një mundësi për asistencë për bashkitë për të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë vendore, jo vetëm për sektorë të veçantë. Nëpërmjet dy thirrjeve për propozime të hapura për të gjitha bashkitë shqiptare, me anë të granteve të investimeve nga kjo skemë do të trajtohen fushat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike vendore, zhvillimi ekonomik vendor, risitë, krijimi i vendeve të reja të punës, mbrojtja e mjedisit dhe fuqizimi i të rinjve. Projekti zbatohet nga NALAS, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore, në partneritet me partnerët lokalë: Eko-Partnerët për Zhvillim të Qëndrueshëm, Shoqata e Autonomisë Vendore dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

The EU4Muncipalities Grant Scheme is a pioneering project of the European Union Delegation to Albania, where the EU provides an opportunity for assistance to municipalities for the entire spectrum of local functions and responsibilities, not just single sectors. Through two calls for proposals open for all Albanian municipalities, the EU4M investment grants will tackle the fields of local public infrastructure and services, local economic development, innovation, job creation, environmental protection and youth empowerment. The project is implemented by NALAS, the Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe, in partnership with the local partners: Eco-Partners for Sustainable Development, Association of Local Autonomy and Co-PLAN, Institute for Habitat Development.

PUBLIKIM NR.4
ISSUE NO.4

Financuar nga Bashkimi Evropian

**EU4MUNICIPALITIES**



## BE PËR BASHKITË, BE PËR KOMUNITETET VENDORE!

**Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve për shërbime më të mira dhe jetesë më të mirë.**

Të dashur lexues,

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim buletinin e katërt të Projektit 'BE për Bashkitë' (EU4M), i financuar nga Bashkimi Evropian. EU4M synon nxitjen e potencialeve të zhvillimit të bashkive, si dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve vendore në Shqipëri.

19 bashki të Shqipërisë janë mbështetur me grante deri në 200,000 EURO për ndërhyrje me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve vendore, për zhvillimin e të rinjve dhe të komunitetit, për edukimin, kujdesin social, kulturën dhe sportet në nivel vendor.

## EU FOR MUNICIPALITIES, EU FOR LOCAL COMMUNITIES!

**Building infrastructure and capacities for better services and better lives!**

Dear reader,

We are pleased to present to you the 4th newsletter of our 'EU for Municipalities' (EU4M) Project. Funded by the European Union, EU4M aims at fostering municipalities' development potential and improving the socio-economic and environmental conditions of local communities in Albania.

19 municipalities in Albania have been supported with grants of up to 200,000 euros for interventions aimed at improving local infrastructure and services, youth and community development, education, social care, culture, and sports at the local level.



# KRYESORE
# HIGHLIGHTS


6

## EDITORIAL

Nga Marie Augouy
Marie Augouy
Menaxhere Programi për Qeverisjen Rajonale dhe Lokale, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

10-15

## ASISTENCË PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE PËR BASHKITË

Capacity development assistance for Municipalitiesere's another teaser paragraph that varies in length

20-29

## BASHKITË DHE PROCESI I INTEGRIMIT NË BE: SHKËMBIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË EVROPËN JUGLINDORE

"Municipalities and EU integration process: Exchanging good practices in South-east Europe"

19

## OPINION NGA ADELINA FARRIÇI

Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore
Executive Director of the Association for Local Autonomy

Financuar nga Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

# EDITORIAL

*Nga Marie Augouy*

*Menaxhere Programi për Qeverisjen Rajonale dhe Lokale, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri*

Gjatë muajve të fundit, EU4Municipalities (BEpër - Bashkitë) së bashku me partnerët e saj dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian patën kënaqësinë të vizitonin disa nga bashkitë e Shqipërisë dhe të merrnin pjesë me autoritetet vendore, komunitetet lokale dhe grupet rinore në inaugurimin e infrastrukturave të reja dhe shërbimeve publike që iu përgjigjen nevojave dhe shqetësimeve të qytetarët. Tani është koha për të prekur arritjet konkrete, për të dëshmuar se sa këto arritje ndikojnë pozitivisht në cilësinë e jetës së komuniteteve dhe për të riafirmuar rolin e rëndësishëm të autoriteteve lokale në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik lokal. Vlen të kujtohet se falë 23 ndërtesave publike lokale të rehabilituara nga programi BE për Bashkitë, qytetarët tani mund të mbështeten në 68 shërbime bashkiake të modernizuara dhe të përmirësuara, nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejtë 49.332 anëtarë të komunitetit lokal, nga të cilët 32.787 janë të rinj.

Duke pasur parasysh që BE për Bashkitë është nisma e parë e BE-së në Shqipëri që ofron mundësi financiare për investime ekskluzivisht për bashkitë, po ashtu është koha për të bërë një bilanc të mësimeve të nxjerra dhe për të ndarë përvojat. Ky ushtrim është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimeve dhe shërbimeve bashkiake gjatë gjithë ciklit të projektit dhe më pas, për të rritur tek bashkitë kapacitetet përthithëse të asistencës financiare të Bashkimit Evropian dhe për të përgatitur autoritetet lokale për të përmbushur detyrimet e ardhshme të anëtarësimit në BE dhe të përfitojnë në mënyrë efikase nga e gjithë gama e mundësive.

Zbatimi i 19 projekteve bashkiake duke angazhuar 19 bashki (1/3 e bashkive shqiptare) paraqet një kampion të mirë të përvojave që kontribuojnë në identifikimin e sfidave ligjore dhe administrative për t'u trajtohet si prioritet në nivelet e qeverisjes vendore dhe qendrore.

Ndërsa vërehet njëfarë progresi në nivel qendror, siç është ndryshimi i ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, në kuadër të IPA III, përvoja tregon se kompleksiteti i proceseve administrative dhe mungesa e harmonizimit kundrejt interpretimit dhe zbatimit të dispozitve administrative mund të çojnë në mundësi të humbura për sa i përket aksesit në fondet e BE-së. Gjithashtu, kjo shpesh rrezikon procesin e zbatimit të projekteve, duke krijuar vonesa të rënda që ndikojnë në menaxhimin e shëndoshë të inputeve të projekteve. Hapja e llogarive bankare të projekteve, transferimi në kohë i fondeve, qartësimi i buxhetit dhe procedurave të prokurimit janë sfida që ende duhet të trajtohen për të arritur një raport më të mirë kosto/efektivitet të projekteve bashkiake dhe për të përfituar nga mundësitë e financimit në dispozicion të BE-së që u ofrohen autoriteteve vendore. Për këtë qëllim, është thelbësor dialogu konstruktiv ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor që ndihmon në një proces administrativ efikas.

Në nivel lokal, është bërë përparim në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për t'u angazhuar më mirë në procesin e anëtarësimit në BE. Krijimi i njësive të integrimit në BE në 61 bashkitë konsiderohet si një hap përpara. Megjithatë, një mësim tjetër i nxjerrë nga programi BE për Bashkitë është se strukturat, si njësitë dhe departamentet bashkiake, duhet të mbështeten me kapacitete të duhura teknike dhe administrative dhe nga mekanizmat efikasë koordinues që synojnë përmirësimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve, por edhe planifikimin, menaxhimin, vlerësimin dhe kontrollin e fondeve dhe projekteve të BE-së. Në veçanti, bashkitë inkurajohen të investojnë në zhvillimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të duhura, në gjetjen e zgjidhjeve inovative për ngritjen e kapaciteteve, si krijimi i rrjeteve dhe bashkëpunimit midis bashkive. Me perspektiva të qarta të integrimit të përshpejtuar, bashkitë do të duhet të sigurojnë në vitet e ardhshme përgatitjen e dukur të nëpunësve vendorë, me një nivel të përshtatshëm stabiliteti dhe qëndrueshmërie për administratën publike. Qasja e të "mësuarit përmes praktikës" të EU4M është në këtë kuptim shumë e rëndësishme.



Vlen të theksohet se administratat publike lokale "zbatojnë 70% të të gjithë legjislacionit të BE-së, 90% të politikave të përshtatjes klimatike dhe 65% të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm". Kjo do të thotë se për të marrë në mënyrë efektive detyrat dhe përgjegjësitë e një shteti të ardhshëm anëtar të BE-së, është thelbësore që të ketë pushtete vendore të fuqizuara, administrata vendore të aftë dhe qytetarë aktivë, grupe sociale dhe biznese.

BE-ja është këtu për të mbështetur përgatitjen e bashkive në Shqipëri për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të anëtarësimit të ardhshëm në BE. Një program i ri prej 10 milionë euro po përgatitet aktualisht së bashku me Qeverinë e Shqipërisë, duke gërshetuar grante për investime në infrastrukturë dhe shërbime dhe asistencë teknike, dhe duke u mbështetur në qasjen e të mësuarit duke bërë. Thirrjet e reja për propozime do të hapen në vitin 2025. Këto mundësi nuk duhen humbur!

Si përfundim, dëshiroj të përgëzoj ekipin zbatues të projektit dhe shoqatat e autoriteteve vendore për përpjekjet dhe angazhimin e tyre në mbështetjen e bashkive të Shqipërisë për t'u angazhuar më shumë dhe më mirë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave dhe shqetësimeve lokale dhe për të forcuar demokracinë lokale. Ftoj gjithashtu të gjitha bashkitë e Shqipërisë që të rrisin në mënyrë aktive kapacitetet lokale dhe të fillojnë përgatitjen e projekteve përmes zgjidhjeve të bazuara në vend, të favorshme për arritjen e shoqërive të drejta. Europa është këtu, në çdo qytet dhe fshat ku jetojnë shqiptarët.




EDITORIAL

*By Marie Augouy*

*Program Manager for Regional and Local Government, Delegation of the European Union in Albania*

Over the last months, EU4M jointly with its partners and the EU Delegation had the pleasure to visit Municipalities of Albania and to participate with local authorities, local communities and youth groups in the inauguration of new infrastructures and public services responding to the needs and concerns of the citizens.

This is now the time to see first-hand the concrete achievements, to witness to what extent this achievements impact positively the quality of life of the communities and to reaffirm the crucial role of local authorities in fostering local socio-economic development. It is worth recalling that thanks to the 23 local public buildings rehabilitated by EU4M, citizens can now count on 68 modernised and improved municipal services benefitting directly to 49.332 local community members, of which 32.787 are young people.

Considering that EU4M is the first EU initiative in Albania offering financial opportunities for investments to Municipalities exclusively, this is also the time to take stock of the lessons learned and to share experiences. This exercise is extremely important in order to improve the quality and sustainability of municipal investments and services during the whole project cycle and after, to increase the EU financial assistance absorption capacities of the Municipalities and to prepare local authorities to meet future EU membership obligations and benefit efficiently from the whole range of opportunities. The implementation of 19 municipal projects engaging with 19 Municipalities (1/3 of Albanian municipalities) represents a good sample of experiences that contribute identifying legal and administrative challenges to be addressed as a priority at local and central government level. While some progress are observed at central level, such as the amendment to the law for VAT ex-ante exoneration under IPA III, the experience demonstrates that the complexity of administrative processes and the lack of harmonisation vis-a-vis the interpretation and application of administrative provisions may lead to missed opportunities in terms of access to EU funds.

This also oftenly results in putting the implementation of projects at risk by creating severe delays impacting the sound management of projects' inputs. Opening projects bank accounts, timely transfer of funds, clarification of budgeting and procurement procedures are challenges that still needs to be tackled in order to reach a better cost/effectiveness ratio of the municipal projects and to benefit from the EU available funding opportunities offered to local authorities. To this end, a constructive dialogue between central and local governments conducive to efficient administrative process is essential.

At local level, progress have been made in creating an enabling environment to better engage in the EU accession process. The establishment of the EU integration units in the 61 Municipalities is considered as a step forward. However, another lesson learned from EU4M project is that the structures, such as municipal units and departments, needs to be sustained by appropriate technical and administrative capacities and by efficient coordination mechanisms aiming at improving service delivery standards but also planning, management, evaluation and control of EU funds and projects. In particular, Municipalities are encouraged to invest in developing and retaining appropriate capacities, in finding innovative solutions to build capacities such as establishing networking and cooperation among municipalities. With clear prospects of accelerated integration, Municipalities will have to ensure in the upcoming years an adequate preparation of local civil servants with an appropriate level of stability and resilience for the public administration. The learning by doing approach developed by EU4M is in that sense very relevant.

It is worth noting that local public administrations "implement 70% of all EU legislation, 90% of climate adaptation policies, and 65% of the Sustainable Development Goals"[1]. This means that to assume effectively tasks and responsibilities of a future EU Member State, it is essential to have empowered local governments, capacitated local administrations and active citizens, social groups and business.

1. *Enhancing the European Administrative Space - COM(2023) 667 final*
















The EU is here to support the preparation of the Municipalities in Albania to respond effectively to the challenges of the future EU membership. A new programme of EUR 10 million is currently under preparation jointly with the Government of Albania, combining grants for investments in infrastructure and services and technical assistance and building on the learning by doing approach. New calls for proposals will be launched in 2025. These opportunities simply cannot be missed!

As a conclusion, I would like to congratulate the project implementing team and the associations of local authorities for their efforts and commitment in supporting the municipalities of Albania to engage more and better in the EU accession process, to respond better to local needs and concerns and to strengthen local democracy. I also invite all the municipalities of Albania to actively enhance local capacities and start preparing projects through place-based solutions conducive to achieving fair societies. Europe is here, in every city and village where Albanians live.

Financuar nga Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

# Asistencë për zhvillimin e kapaciteteve për bashkitë








"BE për Bashkitë", gjatë zbatimit të grantit po ofron mbështetje për bashkitë partnere në përgatitjen e raporteve përfundimtare dhe verifikimet e shpenzimeve.

Vetëm gjatë vitit 2023, "BE për Bashkitë" zhvilloi seanca trajnimi, si dhe ndihmë praktike të përshtatur sipas kërkesave për 190 punonjës të 19 bashkive fituese, në zbatimin e projekteve të tyre. Më konkretisht "BE PËR BASHKITË" zhvilloi 11 trajnime rajonale dhe 12 klinika trajnimi gjatë vitit 2022 për 19 Grantmarrësit, si në vijim:

**9 Trajnime Rajonale për "Menaxhimin dhe Zbatimin e Granteve"** (korrik 2022 – shkurt 2023), duke u fokusuar në sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen bashkitë gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë monitorimin dhe raportimin e granteve, në dobi të 109 punonjësve bashkiakë.

**2 Trajnime Rajonale për Matjen e Rezultateve të Granteve** dhe qëndrueshmërisë me pjesëmarrjen e 18 punonjësve bashkiakë.

**12 Klinika trajnimi për "Menaxhimin dhe Zbatimin e Granteve"** që ofrojnë mbështetje direkte të përshtatur në linjat tematike si në vijim: menaxhim programi, menaxhim financiar, raportim dhe komunikim, me pjesëmarrjen e përgjithshme të 124 punonjësve bashkiakë.




Për të mbështetur të 61 bashkitë shqiptare në kapacitetet e tyre për mbledhjen e fondeve për të absorbuar fondet e BE-së, u zhvilluan 3 trajnime rajonale me temë “Mësimet e nxjerra nga përvoja e “BE PËR BASHKITË” mbi përgatitjen e projekt-propozimeve të BE” organizuar në mars dhe prill 2023, të organizuara së bashku me Projektin Bashkitë për Evropën. Trajnimi ishte i orientuar drejt praktikës dhe përfshinte raste reale të shembujve të suksesshëm.

Së fundi, “BE PËR BASHKITË” po përgatitet për mbylljen e suksesshme të projektit. Ekipi po planifikon aktivitetet e fundit të zhvillimit të kapaciteteve të projektit, duke përfshirë:

a) ofrimin e një seminari teknik dhe tre trajnime rajonale mbi mësimet e nxjerra nga grantet e “BE PËR BASHKITË”; b) hartimin e një dokumenti politikash për krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkitë shqiptare për të absorbuar dhe menaxhuar ndihmën financiare të BE-së; c) Hartimi i një Manuali për Zbatimin e Granteve (së bashku me Komunat për Evropën); d) zhvillimin e një Katalogu për Projektet e financuara nga BE; dhe në fund e) Konferenca Përfundimtare e Projektit, ku dëshirojmë të shohim të gjithë partnerët dhe homologët që festojnë mbylljen e suksesshme të projektit “BE PËR BASHKITË”.

# BE për BASHKITË

# 61 BASHKI

3 TRAJNIME RAJONALE ME TEMË "MËSIMET E NXJERRA NGA PËRVOJA E "BE PËR BASHKITË" MBI PËRGATITJEN E PROJEKT-PROPOZIMEVE TË BE"

## 109 PUNONJËS BASHKIAKË TË TRAJNUAR

9 TRAJNIME RAJONALE PËR "MENAXHIMIN DHE ZBATIMIN E GRANTEVE"

## 18 PUNONJËS BASHKIAKË TË TRAJNUAR

2 TRAJNIME RAJONALE PËR MATJEN E REZULTATEVE TË GRANTEVE

## 124 PUNONJËS BASHKIAKË TË TRAJNUAR

12 KLINIKA TRAJNIMI PËR "MENAXHIMIN DHE ZBATIMIN E GRANTEVE"



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

# Capacity development assistance for Municipalities







During the Grant implementation, the EU4M" is providing support to partner municipalities in the preparation of the final reports and expenditure verifications. For this, during 2023, EU4M" continued to provide training and coaching sessions as well as demand-driven tailored hands-on assistance to the 190 municipal officials from the 19 awarded municipalities in the implementation of their projects.
More specifically EU4M" conducted 11 regional trainings and 12 Coaching clinics during 2022 for the 19 Awarded Grantees on the following:

**9 regional trainings on 'Grants Management and Implementation'** (July 2022 – Feb 2023), focusing on key challenges faced by municipalities during implementation, including grant monitoring and reporting, for the benefit of 109 municipal officials.

**2 Regional Trainings on Measuring the Grants Results and Sustainability** with the participation of 18 municipal officials.

**12 Coaching clinics on 'Grant Management and Implementation'** providing direct tailored support on the following thematic lines: programme management, financial management, reporting and communication, with the overall participation of 124 municipal officials.



To support all 61 Albanian municipalities on their fundraising capacities to absorb EU funding, there were 3 Regional Trainings on “Lessons Learned from the EU4M” experience on EU project proposal preparation” organised in March and April 2023, organised jointly with the Municipalities for Europe Project. The training was practice-oriented and involved real cases of successful and successful examples.

Finally, EU4M” is preparing for the successful closure of the project. The team is planning the last capacity development activities of the project, including:

a) the delivery of one Technical Workshop and three Regional Trainings on Lessons Learned from the EU4M” grants; b) the development of a policy paper on creating an enabling environment for Albanian municipalities to absorb and manage EU financial assistance; c) The development of a Manual on Grants Implementation (jointly with Municipalities for Europe); d) the development of a Catalogue on EU funded Projects; and ultimately e) the Project’s Finale Conference, where we would like to see all the partners and counterparts celebrating the successful closure of EU4M” project.

# EU4MUNICIPALITIES

## 61 MUNICIPALITIES

3 REGIONAL TRAININGS ON "LESSONS LEARNED FROM THE EU4M"

## 109 MUNICIPAL OFFICIALS TRAINED

9 REGIONAL TRAININGS ON 'GRANTS MANAGEMENT AND IMPLEMENTATION'

## 18 MUNICIPAL OFFICIALS TRAINED

2 REGIONAL TRAININGS ON "MEASURING THE GRANTS RESULTS"

## 124 MUNICIPAL OFFICIALS TRAINED

12 COACHING CLINICS ON 'GRANT MANAGEMENT AND IMPLEMENTATION'






# BASHKIA MAT: PALLATI I KULTURËS "SHEFQET DODA" I RIKONSTRUKTUAR

"Jam vërtet i lumtur dhe krenar për kontributin qe Bashkimi Evropian ka dhënë për Burrelin dhe bashkite përreth, me rikonstruksionin e një vendi ku do të mblidheni dhe të manifestoni kulturën tuaj."
Këto ishin fjalët e Ambasadorit të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Silvio Gonzato gjatë ceremonisë së përurimit të rikonstruksionit të Pallatit të Kulturës "Shefqet Doda" në Bashkinë e Matit. Ambasadori Gonzato vlerësoi seriozitetin në zbatimin e këtij projekti të rëndësishëm për komunitetin. "Kemi kënaqësinë të shikojmë rezultatet që kanë dalë nga zbatimi i këtij projekti. Dëshiroj të falenderoj Nalas (Rrjeti i shoqatave të autoriteteve lokale të Evropës Juglindore) sepse është vërtetë e rrallë të gjesh një shoqatë bashkish të aftë për të zbatuar projekte, ku proporcionalisht kuptohen nevojat e bashkive dhe njëkohësisht realizohen ëndrrat e tyre", deklaroi Ambasadori i BE-së.
Kryetari i Bashkisë së Matit Agron Malaj e konsideroi me rëndësi këtë investim dhe shprehu interesin dhe dëshirën për projekte të tjera që do t'i vijnë në ndihmë komunitetit.
Pallati i Kulturës në Mat ofron shërbime për rreth 5 mijë qytetarë, ndërsa për risi është krijimi i Qendrës së Inovacionit për fëmijët dhe të rinjtë.










## MAT MUNICIPALITY:
## RECONSTRUCTION OF THE "SHEFQET DODA" PALACE OF CULTURE

"I am really happy and proud of the contribution that the European Union has given to Burrell and the surrounding municipalities, with the reconstruction of a place where you will gather and manifest your culture." These were the words of the Ambassador of the Delegation of the European Union to Albania, Silvio Gonzato, during the inauguration ceremony of the reconstruction of the Palace of Culture "Shefqet Doda" in the Municipality of Mat.

Ambassador Gonzato appreciated the seriousness of the implementation of this important project for the community. "We are pleased to see the results that have emerged from the implementation of this project. I would like to thank Nalas (the Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe) because it is really rare to find an association of municipalities capable of implementing projects that proportionally understands the needs of the municipalities and at the same time makes their dreams come true," declared the EU Ambassador. The Mayor of Mati Agron Malaj considered this investment important and expressed his interest and desire for other projects that would help the community.



**The Palace of Culture in Mat offers services to about 5,000 citizens, while innovation is the creation of the Innovation Center for children and young people. Since its creation, there have been over 200 young people from the Municipality of Mati registered in the Innovation Center.**














# ADELINA FARRIÇI

**Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore**
Executive Director of the Association for Local Autonomy

**Bashkimi Europian** (BE) është një mbështetës i kahershëm i politikave nxitëse të decentralizmit, forcimit të qeverisjes vendore, si dhe fuqizimit të komuniteteve lokale në Shqipëri. Brenda këtij vizioni, projekti BE për Bashkitë, përmes mbështetjes financiare jetëson projekte novatore që kanë për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të pushtetit vendor, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës publike, si dhe gjithëpërfshirjen e komuniteteve vendore.
Nisma e projektit ka nxitur të zhvillimin e kohezionit social në komunitet, forcimin e trashëgimnisë kulturore dhe cilësinë arsimore duke u gërshetuar në strukturën e projekteve lokale përmes mbështetjes së ideve novatore dhe nxitjes së kreativitetit.

Njëkohësisht, ka ndihmuar në fuqizimin e bashkive përmes shkëmbimit të njohurive dhe bashkëpunimit, duke ofruar një platformë për adaptimin e praktikave më të mira, nxënien nga sukseset e njëri-tjetrit dhe adresimin kolektiv të sfidave për të arritur në vendimmarrje efikase. Kjo frymë bashkëpunimi jo vetëm që forcon bashkitë e përfshira, por gjithashtu pasuron komunitetin dhe e afron atë më shumë me qasjen drejt perspektivës europiane.
Shoqata për Autonomi Vendore duke qënë pjesë e zbatimit të projektit, ka mbështetur dhe promovuar rolin kryesor që luan çdo bashki në këtë përpjekje për zhvillim komunitar. Çdo angazhim, nga një bashki e vogël apo e madhe, kontribuon në mozaikun e progresit. Duke përqafuar këto nisma, ne jo vetëm investojmë në lokalitetet tona, por gjithashtu kontribuojmë në një të ardhme të unifikuar dhe të qëndrueshme drejt integrimit Europian, ndaj është me rëndësi vazhdimësia e iniciativave të tilla!

**The European Union** (EU) is a long-time supporter of policies promoting decentralization, strengthening local governance, and empowering local communities in Albania. Within this vision, the EU4Municipalities project, through financial support, implements innovative projects aimed at developing local government capacities, increasing the quality of services and public infrastructure, as well as the inclusiveness of local communities.

The project initiative has promoted the development of social cohesion in the community, the strengthening of cultural heritage and educational quality by being woven into the structure of local projects through the support of innovative ideas and the promotion of creativity.

At the same time, it has helped empower municipalities through knowledge sharing and collaboration, providing a platform for adapting best practices, learning from each other's successes, and collectively addressing challenges to achieve efficient decision-making. This spirit of cooperation not only strengthens the municipalities involved but also enriches the community and brings it closer to the European perspective.
The Association for Local Autonomy, being part of the implementation of the project, has supported and promoted the main role played by each municipality in this effort for community development.
Every commitment, from a small or large municipality, contributes to the mosaic of progress. By embracing these initiatives, we not only invest in our localities but also contribute to a unified and sustainable future towards European integration, so it is important to continue such initiatives!

Financuar nga
Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

*Forumi i Qeverisjes Vendore:*

# "BASHKITË DHE PROCESI I INTEGRIMIT NË BE: SHKËMBIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË EVROPËN JUGLINDORE"



*Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqata për Autonomi Vendore në Shqipëri, me mbështetjen e projekteve të financuara nga BE, "Bashkitë për në Evropë" dhe "BE për Bashkitë" dhe NALAS organizuan Forumin e Qeverisjes Vendore "Bashkitë dhe Procesi i Integrimit Evropian: Shkëmbimi i Praktikave të Mira në Evropën Juglindore", në Tiranë më datë 13 tetor 2023.*



Cilësia e jetës që përjeton çdo qytetar në zonat urbane dhe rurale përcaktohet kryesisht nga cilësia e shërbimeve publike, infrastrukturës publike dhe hapësirës publike të krijuar dhe menaxhuar nga qytetet dhe bashkitë. Për shkak të përgjegjësive të tyre funksionale, bashkitë luajnë një rol themelor edhe në procesin e integrimit në BE, pasi deri në 70% e Acquis të BE-së zbatohet në nivel vendor. Në forum u nënvizua se me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE), qeverisja qendrore dhe vendore në Shqipëri kanë bërë përparim të rëndësishëm në krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional për autoritetet vendore për të kontribuar dhe përfituar nga procesi i anëtarësimit në BE dhe ndihma financiare e BE-së. BE po mbështet reformat kryesore në fushën e qeverisjes vendore dhe zhvillimit rajonal, ndërsa në të njëjtën kohë po rrit mbështetjen e saj për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve bashkiake nëpërmjet granteve për qeveritë vendore. Në këtë kuadër, Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së në Tiranë, nënvizoi se: "BE do të vazhdojë mbështetjen e bashkive dhe komuniteteve vendore në Shqipëri duke akorduar një shifër prej rreth 10 milionë euro përmes programeve të suksesshme të Bashkimit Evropian për të mbështetur bashkitë nëpërmjet granteve të drejtpërdrejta dhe me asistencë teknike." Roli i pushtetit vendor mbetet i lidhur ngushtë me procesin e integrimit, sidomos në këtë moment kur po shkohet drejt finalizimit të procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit – procesi Screening, pas të cilit nis diskutimi i secilit kapitull në procesin e negociatave Shqipëri – BE. Vetë pushteti vendor ka një zë të veçantë në kapitujt e negocimit, pasi kanë të bëjnë me mjedisin, me sigurinë ushqimore, përfshirjen e dimensionit social, përmirësimin e administratës, e një sërë prioritetesh të tjera zhvillimore. Ministri Shteti për Pushtetin Vendor Z. Arbjan Mazniku, nënvizoi se rreth 70% e legjislacionit të BE-së zbatohet në nivel vendor dhe se ai, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqata për Autonomi Vendore, me mbështetjen e BE-së, po luajnë një rol themelor në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkitë shqiptare që të kontribuojnë më mirë në procesin e anëtarësimit në BE.

Mazniku u shpreh se: "Deri para disa kohësh procesi i integrimit evropian ishte një ëndërr, një vizion i largët, të cilit ne nuk ia shihnim dot fundin. Ndryshimi që ka ndodhur në gjashtë muajt e fundit me shprehjen e qartë të Bashkimit Evropian për një proces të shpejtë dhe teknik të integrimit të të gjithë Ballkanit Perëndimor në BE është si momenti kur marinarët në det shohin tokën."

Z. Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë Tiranë nënvizoi progresin e jashtëzakonshëm të bërë nga Shqipëria, sidomos në vitet e fundit, për përshpejtimin e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë e njëkohësisht ftoi Bashkimin Evropian të ndërmarrë hapa më të drejtpërdrejta dhe të lehtësojë procedurat për bashkitë përsa i përket thithjes dhe menaxhimit të fondeve të BE-së. "Nëse në vitin 1992, Shqipëria renditej e fundit ndër vendet e Ballkanit Perëndimor në proceset e integrimit, sot mund të themi se Shqipëria është e para. Sot jemi të parët në rajon në këtë proces," u shpreh Veliaj.




Drejtor Ekzekutiv i NALAS, Z. Kelmend Zajazi, nënvizoi rëndësinë e pushtetit vendor dhe shoqatave të tyre në procesin e integrimit evropian. "Bashkitë kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit të BE-së (EU Aquis) që krijon kornizën e standardeve për shërbimet, por njëkohësisht kanë rol në jetësimin e standardeve duke modernizuar shërbimet publike. Në këtë kontekst, roli i shoqatave kombëtare të bashkive është shumë i rëndësishëm në procesin e integrimit evropian," u shpreh Z. Zajazi.





Në forum Znj. Adelina Farrici, Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore, theksoi se bashkitë dhe shoqatat e tyre janë pjesë përbërëse e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. “Ato janë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të BE-së në nivel vendor, angazhimin me qytetarët, ndërtimin e kapaciteteve, ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës dhe njëkohësisht promovimin e zhvillimit vendor e rajonal”, tha Farrici.









Ndonëse progresi është shumë i dukshëm, ka shumë fusha në të cilat bashkitë nga Evropa Juglindore mund të përfitojnë nga praktikat dhe përvojat e vendeve fqinje, që kanë përparuar në procesin e anëtarësimit ose që janë tashmë anëtarë të BE-së. Në nivel rajonal, Rrjeti i Shoqatave të Autoritetit Vendor të Evropës Juglindore (NALAS), i mandatuar nga Autoritetet Lokale të Evropës Juglindore dhe shoqatat e tyre, vazhdon të advokojë për një përfshirje më të strukturuar të autoriteteve vendore dhe shoqatave të tyre në procesin e integrimit në BE dhe në krijimin e më shumë mundësive për autoritetet vendore në Ballkanin Perëndimor për të përfituar nga ndihma financiare e BE-së.

Në përfundim të panelit të parë, Z. Elton Stafa, Drejtor i Projektit ‘BE për Bashkitë’, nënvizoi se: “Ky forum është i rëndësishëm si platformë për të shkëmbyer eksperiencat dhe për të ndërvepruar me partnerët nga Evropa Juglindore.”

Gjatë punimeve të forumit u prezantuan praktikat e mira nga Z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, mbi projektet e kësaj bashkie në fushën e efiçencës së energjisë, nga Znj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës mbi nismat për zhvillimin e qëndrueshëm, nga Z. Albert Mëlyshi, Kryetar i Bashkisë Mirditë, mbi rolin e bashkive në fushën e integrimit evropian, nga Znj. Alma Hoxha, Kryetare e Bashkisë Përmet, e cila prezantoi përvojën e Përmetit në forcimin e kapaciteteve të bashkisë për thithjen e fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe nga Z. Hil Curri, Kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz, i cili prezantoi perspektivën e tij mbi nevojën për koordinim mes niveleve të qeverisjes dhe vetë bashkive për të përmirësuar aksesin në fondet e BE-së. Në të njëjtën kohë u prezantuan nga drejtuesja e projektit "Bashkitë për në Evropë", Znj. Jolanda Trebicka, dy publikime të rëndësishme të projektit dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore: "Raporti i Performancës 'Bashkitë në procesin e integrimit në BE'" dhe Raporti i Progresit "Projektet e financuara nga donatorët".

Me interes të veçantë u ndoqën përvojat nga vendet e rajonit si Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroacia, por edhe përtej rajonit, si Austria. Drejtor i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Z. Sazan Ibrahimi, referoi mbi rolin e Shoqatës së Komunave në proceset e integrimit dhe në rritjen e kapaciteteve vendore për thithjen e fondeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Drejtori Ekzekutiv nga Qendra Kërkimore për Administratën Publike dhe Shoqata e Qyteteve dhe Bashkive të Austrisë, Z. Thomas Prorok, nënvizoi nevojën për koordinimin ndërmjet niveleve të qeverisjes për sa i përket procesit të negocimit me BE-në dhe nevojën për bashkëpunim horizontal ndërmjet bashkive dhe shoqatave të qeverisjes vendore.

Z. Marko Ercegović, nga Shoqata e Qyteteve të Kroacisë, nënvizoi rëndësinë e ngritjes së kapacitete administrative për thithjen e fondeve të BE-së dhe zbatimin e rregullave të BE-së për zbatimin e projekteve, e sidomos mbështetja e qeverisjes qendrore me financime për hartim projektesh dhe për bashkëfinancimin.

